

VENDIM
Nr.430, datë 21.3.2006

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË RADIOS “FANTASY”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, neni 7 pika 21, neni 25 dhe 33, pika 1, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” dhe vendimi nr.404, datë 30.11.2005, të Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit, ky i fundit

VENDOSI:

1. Në mbarim të fatit të licencimit, nuk rinovohet licenca për subjektin Radio “Fantasy”, pasi nuk ka shfaqur interes për rinovimin e saj.
2. Licenca me nr.039/FML bëhet e pa vlefshme.
3. Subjekti sipas pikës 1 të këtij vendimi ka të drejtën e ankimit në gjykatë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj